



Aplikim për vizë me qëllim punësimi si babysitter (Au-Pair)

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit. Si pasojë do të nevojitet rezervimi i një date të re aplikimi përfshirë periudhat përkatëse të pritjes.

Parimisht vlen sa më poshtë:

1. Moshë minimale për t'u punësuar si Au-Pair është 18 vjeç, ndërsa ajo **maksimale 26** (ditën e aplikimit për vizë).
2. Mes babysitter-it dhe prindërve hospites **nuk duhet të ketë marrëdhënie farefisnie**. Në familjen pritëse duhet të flitet **gjermanisht si gjuhë amtare**. Nëse brenda familjes gjermanishtja flitet vetëm si gjuhë e familjes, dhe jo si gjuhë amtare, atëherë viza mund të lëshohet, nëse babysitter-i nuk vjen nga i njëjti vend i origjinës së prindërve hospites.
3. Qëndrimi si Au-Pair në Gjermani zakonisht është i mundur vetëm një herë.
4. Gjatë aplikimit në Ambasadë ju do të merrni një fletë informacioni rreth të drejtave dhe detyrimeve tuaja në kuadër të qëndrimit si Au-Pair; marrjen e kësaj flete informacioni do të duhet ta konfirmoni në një deklaratë.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht 2 deri në 4 javë. Ndaj lutemi që të aplikoni për vizë në kohën e duhur, sikundër edhe për për mirëkuptimin Tuaj që brenda 5 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:

1.	Formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, 2 copë , të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht.
2.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75,00 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	Fotografi pashaporte	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.
Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, me 2 fotokopje, në momentin e aplikimit		
4.	Pashaporta e udhëtimit	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më

		i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
5.	Kontrata e angazhimit si babysitter	Në origjinal, në gjuhën gjermane ose angleze. Një kontratë-model mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Agjencisë Federale të Punës www.arbeitsagentur.de Kontrata duhet të përmbajë kushtet minimale për marrëdhënien Au-Pair: <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimin e saktë të palëve në kontratë • Numrin dhe moshën e fëmijeve që duhen shoqëruar (në familje duhet të jetojë të paktën një fëmijë minoren) • Fillimi dhe kohëzgjatja e kontratës (të paktën 6 muaj, maksimumi 1 vit) • Detyrimet e përgjithshme të prindërve hospites • Detyrimet e përgjithshme të Babysitter-it • Detyrimi i prindërve hospites për lidhjen e një kontrate sigurimi për shëndetin, shtatzaninë, lindjen dhe aksidentet. • Marrëveshja për shumën e parave të xhepit (në muaj të paktën 260 euro, plus para xhepi për frekuentimin e një kursi gjuhe) • Marrëveshje për kohën e punës (maksimumi 6 orë në ditë dhe 30 orë në javë) • Marrëveshje për ditët e pushimit (të paktën 2 ditë pune në muaj)
6.	Eventualisht shkresë e agjencisë ndërmjetësuese	Nëse kontrata e angazhimit si baby-sitter është realizuar përmes një agjencie ndërmjetësimi, atëherë shkresa e agjencisë duhet të bashkëngjitet. Informacione të mëtejshme gjeni në www.guetegemeinschaft-aupair.de
7.	Dëshmi për njohuritë e gjermanishtes	Nisur nga një vendim i Bundestag-ut Gjerman i vitit 2003 për përmirësimin e ndërmjetësimit Au-Pair me qëllim ndalimin e efektshëm të rasteve të shfrytëzimit dhe abuzimit, në momentin e aplikimit do të realizohet një test i gjuhës gjermane, me gojë, në nivelin minimal A1.
8.	Shkresë motivimi nënshkruar nga vetë personi	Shkresë motivimi në origjinal, e formuluar në shqip me përkthim në gjuhën gjermane
9.	Jetëshkrim	Në origjinal – Jetëshkrimi duhet të hedhë një vështrim në jetën dhe përvojat profesionale.

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen dokumenta të caktuara të papërmendura më sipër.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.